



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 255, datë 09.07.2020

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarin për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatën në nevojë si vijon:

**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN
E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Emona Muçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; të pandehur: {...} dhe {...} ; Akuza: “Nenet 283/a/2, 22, 28/4, 333/a të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, {...}, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Rexhep Bektashi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; të pandehur: {...}, {...} , {...} , {...}; Akuza: “Nenet 283/a/2, 22, 28/4, 333/a të Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ornela Naqellari, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Manjola Xhaxho, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i pandehur {...}; Akuza: “Nenet 284/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Esmeralda Xhili (relatore), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Alma Kolgjoka si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ornela Naqellari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Nenet 283/a/2, 22, 28/4, 333/a të Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Flutura Skënderi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative së Apelit, çështjen gjyqësore me kërkues: Shoqëria “{...}” sh.p.k; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Flutura Skënderi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative së Apelit, çështjen gjyqësore me kërkuese {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**